REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

**Nr. 60 datë 17/08/2018**

# PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI 6% PËR PERIUDHËN 1-31 KORRIK 2018

Në mbështetje të nenit 29, 30/1,31 të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016, datë 21.04.2016, në pikën 6 të Kreut II të Vendimit nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me Vendimin nr.592, datë 18.10.2017, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 955 datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", dhe udhëzimeve në zbatim te tyre, Këshilli i Bashkisë ,

**VENDOSI :**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin **Korrik 2018** në total **8 (tetë)** familje, me fond total prej **33480 (tridhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë)** lekë. Konkretisht:

**PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Korrik 2018 **4 (katër)** familje, me një fond **13500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind)** lekë.

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE STRUM**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Korrik 2018 **1 (një)** familje me një fond **5400 (pesë mijë e katërqind)** lekë.

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Korrik 2018 **1 (një)** familje, me një fond **3600 (tre mijë e gjashtëqind)** lekë.

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Korrik 2018 **2 (dy)** familje , me një fond **10980 (dhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë)** lekë.

KRYETAR

Bashkia Roskovec

Korrik 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

| Nr | Emer Atesi Mbiemer | Nr.dosjes | Nr.Frymeve | Lloji i ndihmës ndihmes | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drita Kovaç Latifi | | 2 | Familje në nevojë | 3060 |
| 2 | Arjana Kodhel Hajdini | | 3 | Familje në nevojë | 4320 |
| 3 | Nerlina Petref Çepele | | 2 | Familje në nevojë | 3060 |
| 4 | Haxhire Barjam Çepele | | 2 | Familje në nevojë | 3060 |
| | **Shuma** | | | | **13500** |

Mbyllet me nr rendor 4 (katër)

**KRYETAR KËSHILLI**

**Eleni Goga**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC

Njësia Administrative Strum
Korrik 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

| Nr | Emer Atesi Mbiemer | Nr.dosjes | Nr.Frymeve | Lloji i ndihmës ndihmes | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nurije Myrtezan Dogani | | 5 | Familje në nevojë | 5400 |
| | **Shuma** | | | | **5400** |

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

**KRYETAR KËSHILLI**
**Eleni Goga**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC

Njësia Administrative Kuman
Korrik 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

| Nr | Emer Atesi Mbiemer | Nr.dosjes | Nr.Frymeve | Lloji i ndihmës ndihmes | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Blerina Skënder Rexha | | 3 | Familje në nevojë | 3600 |
| | **Shuma** | | | | **3600** |

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

**KRYETAR KËSHILLI**
**Eleni Goga**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË -BASHKIA ROSKOVEC

Njësia Administrative Kurjan

KORRIK 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

| Nr | Emer Atesi Mbiemer | Nr.dosjes | Nr.Frymeve | Lloji i ndihmës | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Llanita Azim Baxhia | | 5 | Familje në nevojë | 6120 |
| | Laureta Ramadan Myftari | | 4 | Familje ne nevoje | 4860 |
| | **Shuma** | | | | **10980** |

Mbyllet me nr rendor 2(dy)

**KRYETAR KËSHILLI**

[illegible]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

# VENDIM

NR 61 .DATE 17.08.2018

## *"PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGES "GOGALLARET", + RRUGËS SË VARREZAVE, LAGJIA QENDER, FSHATI NGJEQAR"*

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjes Vendore"*, i ndryshuar, neni 23 pika 4; ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar neni 12 dhe neni 13, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015,"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI:**

1- Miratimin e Projektit të objektit: Rikonstruksion i rrugës "Gogallaret",L=890 ml +rrugës së Varrezave, Lagjia Qendër, L=280 ml, fshati Ngjeqar"

Projekti përmban sistemimin dhe shtrimin me rërë bituminoze të Rrugës "Gogallarët" në fshatin Ngjeqar me një gjatësi prej L=890 ml dhe gjerësi prej 3.5m. Gjithashtu një rrugë e cila do të mundësoj aksesin me varrezat e fshatit është edhe rruga e Varrezave, Lagjia Qendër, me gjatësi prej L=280 ml e cila po ashtu do të shtrohet me rërë bituminoze. Gjendja aktuale e rrugëve vështirëson qarkullimin normal të banorëve të zonës pasi atyre u mungon sistemimi i ujërave dhe janë të shtruara me shtresë zhavorri ose cakëll.

Projekti përmban edhe krijimin e një sheshi në hyrje të varrezave duke mundësuar lehtësi hyrje për në varreza.

2- **Vlera totale e projektit: 6 750 160 lekë me TVSH**
3- **Burimi i financimit të këtij projekti –Bashkia Roskovec**

**KRYETAR**
**Eleni GOGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

# VENDIM

NR 62 .DATË 17.08.2018

## *PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS "KUMAN-LUAR-VIDHISHTË"*

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjes Vendore"*, i ndryshuar, neni 23 pika 4; ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar neni 12 dhe neni 13, dhe VKM nr. 408, date 13.05.2015,"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI:**

1- Miratimin e Projektit të objektit: Rikonstruksion i rrugës "Kuman-Luar-Vidhishtë"
Projekti ka për qëllim rikonstruksionin e plotë të rrugës Kuman-Luar-Vidhishtë.Rruga është në një gjendje të atillë që vështirëson kalimin e mjeteve si edhe të banorëve.Është e pashtruar dhe pa kanalizime të ujërave.Gjatësia e kësaj rruge është 6.5 km.Është bërë një studim gjeologjik për të mënjanuar shkarjet e dheut që kanë ndodhur për shkak të relievit.
- Gjatësia e rrugës e cila do të rehabilitohet është 2210 ml nga shkolla Jorgo Sopiku Luar deri tek rruga lagja Ndreka.Gjerësia e rrugës është e planifikuar 4 m me asfalt + 2x 0.5 m bankin me çakull.Projekti parashikon hedhjen e shtresave çakull,stabilizant,binder dhe asfalto beton,vepra arti si edhe kanale kullues anësore + bankina.
Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni i rrugës Kuman-Luar-Vidhishtë që do të shërbejë për qytetarët dhe mjetet e zonës.Në këtë mënyrë rikonstruksioni i saj ndikon në ekonominë e zonës duke lehtësuar transportin e produkteve bujqësore dhe e prodhimeve të fermerëve.

2- **Vlera totale e projektit: 39,196,334 lekë me TVSH**
3- **Burimi i financimit të këtij projekti –Bashkia Roskovec**

**KRYETAR**
**Eleni GOGA**

2018 - VITI MBAREKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KESHILLI BASHKIAK**

**Nr._63__, date_17/08_/2018**

***"PER MIRATIM NDRYSHIM FONDESH PER INVESTIME NE BUXHETIN E BASHKISE PER VITIN 2018"***

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore",Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH", te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore",Udhezimi nr.9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", te VKB nr.76 date 22.12.2017 "Per miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2018", si dhe materjaleve te sjelle nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Teritorit; Keshilli i Bashkise;

**VENDOSI:**

**I. Miratimin e zbritjes nga plani per investimeve , te objekteve te meposhtme:**

1.Ndertim kopshte dhe ambulance, lagja Shushenjtë,fshati Luar, me kod projekti 1130181 dhe me vlere te plote te objektit 5,270,000 leke.

2.Rikonstruksion i ambulances Marinez me kod projekti 1130181 dhe me vlere te plote te objektit 1,890,000 leke.

3.Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Lagjia Qender,fshati Ngjeqar me kod projekti 1130188 dhe me vlere te plote te objektit 2001000 leke.

4.Mbushje me çakëll i rrugëve te brendeshme, fshati Luar me kod projekti 1130188 dhe me vlere te plote te objektit 1500000 leke.

5.Rikonstruksion i rrugës së Varrezave,lagjia e Mesit Luar me kod projekti 1130188 dhe me vlere te plote te objektit 2844000 leke.

6.Rikonstruksion rruga e Varrezave (Asfaltim +trotuar+ ndricim),fshati Marinez me kod projekti 1130188 dhe me vlere te pjesshme te objektit 10,586,520 leke.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC

II. **Miratimin e objekteve te reja per investime si me poshte vijone:**

**1. Shtohet:**

| NR | GR | TIT | KAP | ART | EMERTIMI I OBJEKTIT | Vlera e plote e objektit | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion I rruges "Gogallaret",L=890 ml+rruges se varrezave,Lagjia Qender ,L=280 ml, fshati Ngjeqar | **6,750,160** | 500,000 | 6,250,160 | 0 |
| 2 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion I rruges Kuman-Luar-Vidhishte, Pr 1900-4110,L=2210 ml, b=4+2x0.5 m | **39,196,334** | 5,920,462 | 33,275,872 | 0 |
| 3 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Kontrata shtese per objektin: "Rikonstruksion i rrugës Lagjia Cobenjtë + Ndërtim trotuari në rrugën e Lagjes Kafaj,fshati Strum" | **1,813,538** | 1,813,538 | | 0 |
| | | | | | **SHUMA:** | **47,760,032** | **8,234,000** | **39,526,032** | **0** |

**2. Pakesohet:**

| NR | GR | TIT | KAP | ART | EMERTIMI I OBJEKTIT | Vlera e plote e objektit/pa prokuruar | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 00 | 09120 | 5 | 231 | Ndertim kopshte dhe ambulance, lagja Shushenjtë,fshati Luar | 5,270,000 | 1,500,000 | 3,770,000 | 0 |
| 2 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i ambulances Marinez | 1,890,000 | 1,890,000 | 0 | 0 |
| 3 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Lagjia Qender,fshati Ngjeqar | 2,001,000 | 500,000 | 1,501,000 | 0 |
| 4 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Mbushje me çakëll i rrugëve te brendeshme, fshati Luar | 1,500,000 | 1,500,000 | 0 | 0 |
| 5 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i rrugës së Varrezave,lagjia e Mesit Luar | 2,844,000 | 2,844,000 | 0 | 0 |
| 6 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion rruga e Varrezave (Asfaltim +trotuar+ ndricim),fshati Marinez | 10,586,520 | 0 | 10,586,520 | 0 |
| 7 | 00 | 08250 | 5 | 231 | Sistemimi i fushës së sportit, Vidhishtë | 523,480 | 0 | 523,480 | 0 |
| 8 | 00 | 06330 | 5 | 231 | KUZ lagjia te ish-komuna Kuman -Faza III | 452,848 | 0 | 452,848 | 0 |
| 9 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i rrugës së lagjes Kurtaj,fshati Ngjeqar- Faza I (Gërmime + Vepra arti,mbushje cakull ) | 414,920 | 0 | 414,920 | 0 |
| 10 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Lagjia Shabanaj , fshati Ngjeqar | 188,150 | 0 | 188,150 | 0 |
| 11 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i rrugës së Varrezave,fshati Vlosh | 633,600 | 0 | 633,600 | 0 |
| 12 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Rikonstruksion i rrugës Lagjia Cobenjtë + Ndërtim trotuari në rrugën e Lagjes Kafaj,fshati Strum | 380,048 | 0 | 380,048 | 0 |
| 13 | 00 | 06330 | 5 | 231 | Asfaltim i rruges kryesore - Velmish | 4,315,200 | 0 | 4,315,200 | 0 |
| 14 | 00 | 04520 | 5 | 231 | Rikonstruksion I rrjetit rrugore te bashkise | 16,760,266 | 0 | 16,760,266 | 0 |
| | | | | | **SHUMA:** | **47,760,032** | **8,234,000** | **39,526,032** | **0** |

Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe GMS per zbatimin e ketij vendimi .

**KRYETAR**

**Eleni GOGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

**NR 64 DATË 17.08.2018**

***"PËR KRYERJEN E PROÇEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN***

***"REHABILITIMI I BLLOKUT URBAN NR.2 ROSKOVEC'***

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen Vendore"neni 9 pika 1.2 gërma a,b,c,neni 54;të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 për " Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"nenet 5,6.7.8,9.10 : **VKM nr. 89, datë 3.2.2016** "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", **VKM, nr. 127, datë 23.3.2000** për " Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" **VKM, nr. 138, datë 23.3.2000** për "Kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik". Këshilli i Bashkisë.

**VENDOSI :**

1. Miratimin për kryerjen e procedurave të shpronësimit për zbatimin e projektit "*Rehabilitimi i bllokut urban nr.2 Roskovec*" , vlera e shpronësimeve për pronat si më poshtë "**tokë bujqësore**" do të jetë :

   - Nga zbatimi I projektit ***"Rehabilitimi i bllokut urban nr.2 Roskovec",***
     **Për të ndierin Gëzim Pirra :**
     **Sipërfaqja që preket nga ndërtimi i "Stacionit të Policisë" / sipërfaqja për të cilën do të shpronësohet = 1450 m2 x 269 lekë/m2** (*cmimi sipas VKM-së përkatëse për qytetin Roskovec*) **= 390 050 lekë.**

   - Nga zbatimi I projektit ***"Rehabilitimi i bllokut urban nr.2 Roskovec",***
     **Për të ndierin Servet Pirra :**
     **Sipërfaqja që preket nga ndërtimi i "Stacionit të Policisë" / sipërfaqja për të cilën do të shpronësohet = 2500 m2 x 269 lekë/m2** (*cmimi sipas VKM-se përkatese për qytetin Roskovec*) **= 672 500 lekë.**

2. Burimi i financimit- Buxheti i Bashkisë Roskovec , miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.76 datë 22.12.2017 "Për miratimin e buxhetit dhe të numrit maksimal të punonjësve të bashkisë për vitin 2018".

Sipërfaqja totale e sheshit të ndërtimit të "Stacionit të Policisë" Roskovec është 2123.2 m2.

KRYETARI
Eleni Goga

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

# VENDIM

**NR65. DATË 17.08.2018**

***RIKONSTRUKSION UJËSJELLSI I FSHATIT LUAR ,BASHKIA ROSKOVEC***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjes Vendore"*; të Ligjit Nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar.Këshilli i Bashkisë,

**<u>VENDOSI :</u>**

Miratimin e rikonstruksionit të Ujësjellësit të fshatit Luar,Bashkia Roskovec.

Projekti ka për qëllim rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Luar, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec. Rikonstruksioni i kësaj linje të re të ujit të pijshëm do t'u mundësojë banorëve furnizmin e vazhdueshëm me ujë, për kryerjen e nevojave të tyre jetike.

Projekti i ka kushtuar rëndësi cilësisë së materialeve me të cilat do të rikonstruktohet ky rrjet, dhe njëkohësisht është marrë parasysh që linjat ekzistuese të rikonstruktohen si edhe të kalojnë pranë atyre zonave të banuara ku është i amortizuar tubacioni i ujit të pijshëm.

Materiali për shtratin do të shpërndahet dhe nivelohet në mënyrë të tillë, që të krijojë një shtrat të vazhdueshëm dhe uniform për mbështetjen e tubave në të gjitha pikat që nga puseta deri tek bashkimet. Shtrimi i tubave do të bëhet në nivelin, thellësinë dhe përmasat e treguara në projekt.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA

Mbushja dhe mbulimi i kanaleve do të bëhet pasi të ketë përfunduar gërmimi dhe pastrimi i kanaleve. Projekti parashikon ndërtimin e pusetave të kontrollit dhe ato ajruese, si dhe aspekte të tjera teknike të nevojshme.

Qëllimi i këtij objekti, është sigurimi i furnizimit me ujë të një mase të konsiderushme banorësh dhe rritja e mirëqënies së komunitetit.

1- **Vlera totale e projektit: 26.400.913 lekë me TVSH**
2- **Burimi i financimit – Buxheti i Shtetit**

K R Y E T A R
**Eleni Goga**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC -